



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo	
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit / Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta	
Ministry of Culture, Youth and Sports	
Ref.Nr.	4042/2023
Data	11/08/2023
Datum	
Date	
Nënshkrimi	
Signature	
PRISHTINE, PRISTINA, PRISHTINA	

**Republika e Kosovës**

**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**Qeveria – Vlada – Government**

**Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit / Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta /**

**Ministry of Culture, Youth and Sports**

**Kabineti i Ministrimit**

**Kabinet Ministra**

**Minister's Office**

Nr.143/2023

Datë: 11.08.2023

Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, z. Hajrulla Çeku, në mbështetje të nenit 145 (pika 2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, bazuar në nenin 11 të Ligjit Nr. 08/L -117 Për Qeverinë e Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh neni 10 dhe 11 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare, Nr. 7/01 mars 2019), si dhe pikën 8 (tetë) të Shtojcës 1 (një) të Rregullores (QRK) Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 02/L-088 për Trashëgimi Kulturor, Rregulloren NR. 11/2022 Për Inventarizimin dhe procesin e përzgjedhjes së Trashëgimisë Kulturorë për Mbrojtje, nxjerr këtë:

#### V E N D I M

1. Aprovohet rekomandimi me numër të protokollit 3639/2023 i datës 14.07.2023 i Komisionit Profesional Shqyrtues i kërkesave - propozimeve të reja për përfshirje në Listën e Trashëgimisë Kulturorë për Mbrojtje të Përkohshme, aseteve apo përmbajtjeve me forma të shprehjes kulturorë - Kategoria e Trashëgimisë Shpirtërore “ Festivali Kosovarja Këndon - Ferizaj”.
2. Obligohet QRTK- Ferizaj që asetin sipas pikës 1 të dispozitivitetit të këtij vendimi ta regjistrojë në databazë, t’i japë numrin unik, ta kategorizojë sipas Ligjit në fuqi dhe ta përfshijë në Listën e Trashëgimisë Kulturorë për Mbrojtje të Përkohshme, në kategorinë e Trashëgimisë Shpirtërore.
3. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

## Arsyetim

Kërkesën për përfshirje në Listën e Trashëgimisë Kulturore në Mbrojtje të Përkohshme të “Festivalit Kosovarja Këndon” e ka parashtruar Komuna e Ferizajt, Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit në shkresën me Nr. protokolli 1400/2023 të datës 20.03.2023. Propozimi është dërguar nga Departamenti i Trashëgimisë Kulturore (DTK) në MKK për t’u shqyrtuar tutje në Komisionin Profesional Shqyrtues (KPSH) i Muzeut Kombëtar të Kosovës (MKK).

KPSH në MKK e ka dhënë rekomandimin që Festivali Kosovarja Këndon-Ferizaj të përfshihet në listën e Trashëgimisë kulturore për mbrojtje të përkohshme në kuadër të kategorisë Trashëgimi Shpirtërore.

Komisioni Profesional Shqyrtues i DTK pas shqyrtimit të lëndës, formularit të inventarizimit të punuar nga KPSH i MKK dhe rekomandimit të tij, e rekomandon për përfshirje në listën e trashëgimisë kulturore në mbrojtje të përkohshme “Festivalin Kosovarja Këndon” për arsye se i përmban këto vlera:

### **Vlerë historike**

Është themeluar qysh në vitin 1972 është një prej festivaleve më të vjetra që kanë vepruar në Kosovë;

### **Vlerë të raritetit**

Është festival i veçantë pasi që në të kanë marrë pjesë vetëm gratë, dhe ka pas ndikim në emancipimin e gruas në përgjithësi në shoqërinë Kosovare;

### **Vlerë artistike**

Është festival në të cilin janë promovuar vlerat e mirëfillta të këngëve të rajonit dhe përmes këtij festivali janë promovuar këngëtarët e reja, të cilat kanë vazhduar më tej karrierën e tyre profesionale në festivale tjera;

### **Vlerë shoqërore**

Për arsye se ka qenë një ndër festivalet e vetme në atë kohë i cili ka qenë shumë i rëndësishëm për jetën kulturore asokohe për të gjitha komunitetet në Kosovë;

### **Vlerë shpirtërore**

përmes festivalit janë transmetuar njohuritë dhe aftësitë midis brezave duke u ofruar komuniteteve ndjenjën e identitetit dhe të vazhdimësisë.

Andaj, nga kjo që u tha si në dispozitivin e këtij vendimi, “Festivali Kosovarja Këndon” listohet në kategorinë e trashëgimisë shpirtërore me status të mbrojtjes së përkohshme.

*Vendimi i dërgohet:*

- Kabinetit të Ministrisë;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Komisionit Shqyrtues;
- Departamentit të Trashëgimisë Kulturore;
- QRTK - Ferizaj;
- Departamentit Ligjor;
- Arkivit të MKRS-së.

